


D. 4. Përkrahje
Të miratimit
100%
100%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Nr. ____ Prot

Tiranë, më __/__/2019

Lënda: Amendament për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

Drejtuar: Zotit Gramoz RUÇI

KRYETARI I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim e miratim, në seancë plenare, dy amendamente në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, me përmbajtje si më poshtë:

Në nenin 17 të projektligjit të bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 hiqet;
- Në pikën 2 fjalët “para datës 1 korrik 2019” zëvendësohen me fjalët “para datës 1 tetor 2019”.
- Në pikën 3, fjalët “të përcaktuara në nenet 3, 5, 7 dhe 10 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “të përcaktuara në nenet 3, 5, 6, 7 dhe 10 të këtij ligji”;
- Ndryshon numri i pikave të këtij neni.

Neni 18 riformulohet si më poshtë:

“Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 2, nenit 8 pika 1 dhe nenit 10 të këtij ligji, të cilët hyjnë në fuqi më 1 tetor 2019.”

DEPUTETI PROPOZUES

Arben AHMETAJ

